



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Nr 220 prot

Tiranë, më 8.2 2021

VENDIM

Nr. 14, Datë 8.02.2021

**PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT TË INTEGRUAR
PROFESIONAL
TË AUDITUESVE TË KLSH-së, PËR VITIN 2021**

Bazuar në nenin 39 “Trajnimet profesionale”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, (ISSAI), përkatësisht neni 14, pika 3, të ISSAI - P1 “Deklarata e Limës” mbi vëmendjen e veçantë që i kushtohet përmirësimit të zhvillimit teorik, praktik dhe profesional të të gjithë anëtarëve dhe stafit të auditimit; Parimit 12 “Ngritja e kapaciteteve përmes promovimit të të mësuarit dhe shkëmbimit të njohurive” të ISSAI - P12 “Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), sjellja e ndryshimeve në jetën e qytetarëve”; praktikave më të mira ndërkombëtare që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm profesional që kontribuon në përsosjen organizative dhe në zbatim të kuadrit të objektivave të zhvillimit institucional,

VENDOSA:

1. Miratimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Audituesve të KLSH-së” për vitin 2021.
2. Miratimin e Plan - Veprimit, mbi zbatimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Audituesve të KLSH-së” për vitin 2021, si dhe listës emërore të trajnerëve të brendshëm të KLSH-së.
3. Departamenti i Metodologjisë, Standardeve dhe Kontrollit të Cilësisë së Auditimit, Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit, ngarkohen me zbatimin, monitorimin, ndjekjen

dhe raportimin periodik të Plan - Veprimit, mbi zbatimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Audituesve të KLSH-së”, për vitin 2021.

4. Të gjithë punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, kanë detyrimin e zbatimit të detyrave dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara në Programin e Zhvillimit të Integruar Profesional të Audituesve dhe Plan - Veprimit, në zbatim të tij.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Arben SHEHU

